



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

1	Data	13.09.2024	Vendi	Kaçanik
	Mj. org.		Numri	
			Shtojcë	
		08-320/01-22892/24		

Islamic Relief Kosova

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

## NJOFTIM

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Ndërmjet Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë dhe Komunës Kaçanikut, njofton fermerët e komunës së Kaçanikut për aplikim, në projektin – **mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor (freza për tërheqje me traktor 1.6m, makina spërkatëse për kulturat lavërtare, kositëse me pjator, makina mbjellëse të grurit, makina mbjellëse 4 rendëshe të misrit, makina mbjellëse për patate si dhe moto kultivator me freza dhe kositëse.** Në këtë projekt do të përkrahen fermerët, me mekanizmin e lartëcekur.

### **Kushtet e aplikimit për motokultivator:**

- Të jetë banor rezident i komunës së Kaçanikut.
- Të disponoj sipërfaqe të tokës bujqësore minimum 0.30 ha.
- Fermeri të jetë i gatshëm të participoj në 20% vlerës së moto kultivatorit me freza

**Kushtet e aplikimit për mekanizmin bujqësor: freza për tërheqje me traktor 1.6m, makina spërkatëse për kulturat lavërtare, makina kositëse me pjator, makina mbjellëse të grurit, makina mbjellëse të misrit, makina mbjellëse të patatës):**

- Të jetë banor resident i komunës së Kaçanikut.
- Të disponoj sipërfaqe të tokës bujqësore minimum 1.00 ha.
- Fermeri të posedoj traktor për tërheqjen e mekanizmit bujqësorë.
- Fermeri të jetë i gatshëm të participoj në 20% vlerës së paisjes

## **Përparësi:**

- Aplikuesit të cilët nuk janë përfitues të mëhershëm të ndonje subvencioni komunal apo përkrahje tjetër, me mekanizëm bujqësor.
- Familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale
- Familjet që kanë persona me aftësi të kufizuara
- Afati i aplikimit: 16.09. 2024 deri më 04.10.2024**

## **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Formulari për aplikim
- Kopje e dokumentit identifikues
- Çertifikatën e bashkësisë familjare
- Çertifikata e pronës (fleta poseduese)
- Çertifikatën e regjistrimit të fermerit (numëri identifikues i fermerit - NIF-in)

Të interesuarit për më shumë informata mund të drejtohen në zyret e DBZHRP-së, kati parë, në objektin e Administratës Komunale.



Drejtori i DBZHRP

  
Suhad Dullovi